

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË PËR PROJEKTIN “MODERNIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR SHQIPTAR”

Raporti Përfundimtar “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e aktivitetit shtator 2006 deri me Shtator 2013, kryer Ministrinë e Shëndetësisë për Projektin “Modernizimi i sistemit shëndetësor Shqiptar” me objekt: *“Mbi marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit; Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit; Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave; Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje, me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës; Mbi zbatimin e kontratave për punimet e ndërtimit, mallrave dhe shërbimeve”*, është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 168 datë 29.12.2013.

Bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 703/9 prot., datë 30.12.2013 dërguar z. Ilir Beqaj Ministër i Shëndetësisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave për ndryshime të legjislacionit në fuqi, organizative, për shpërblim dëmi, administrative, disiplinore dhe penale.

Masat organizative të rekomanduar dhe kërkuara janë: Ministria e Shëndetësisë të marrë masa:

- për të zbatuar me përpikmëri të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare për projektet me financime të huaja, lidhur me mënyrën e raportimit me donatorët, ritmet e disbursimeve, si dhe objektivat e komponentët e projekteve.
- për të bërë rakordimet me Ministrinë e Financave për financimin e fondeve sipas komponentëve, pasi është konstatuar se janë tejkaluar, pa bërë më parë amendamentimin e marrëveshjes financiare.
- për të bërë një analizë të plotë dhe të gjithanshme të shpenzimeve të kryera për Projektin “Modernizimi i sistemit shëndetësor Shqiptar”, me synim sistemimin e mangësive të evidentuara në regjistrimet kontabël, dhe përlllogaritjen e kostos totale të projektit.
- për menaxhimin me efektivitet të investimeve të kryera nga Projekti, si ato të teknologjisë dhe të ndërtimit të kapaciteteve dhe të ndërtohen politika afatgjatë në fushën e Projekteve.
- për projektet me financime të huaja, të detajojë strukturën e shpenzimeve të projektit në funksion të realizimit dhe implementimit të kategorive dhe komponentëve përkatëse.
- që pajisjet mjekësore të Projektit të pavëna në punë, t’u shpërndahen menjëherë sipas nevojës pavijoneve të tjera të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ose spitaleve të tjerë.
- për të unifikuar procedurat për blerje me vlera të vogla, si masa të nevojshme dhe si një mjet i domosdoshëm që përmirëson menaxhimin dhe administrimin e projekteve me financime të huaja, me synim rritjen efektivitetit dhe arritjen e objektivave të tyre.
- për projektet që do kryhen në të ardhmen, llogaritja e vlerës së kostos së kontratës të kryhet e dokumentuar, duke u mbështetur në çmimet e botuara ndërkombëtare, çmimet e realizuara nga projektet e mëparshme nga vetë MSH, nga kreditë dhe Grantet, INSTAT-i, si dhe çmime të tjera zyrtare etj.
- për të marrë në dorëzim pajisjet kompjuterike të njësisë së zbatimit të projektit.

- për projektet që do të kryhen në të ardhmen, zbatimi i kontratave dhe amendimi i tyre të kryhet me delegim kompetence nga Ministri i Shëndetësisë ose përfaqësuesi i tagrave të tij.
- të marrë masa për planifikimin e fondeve në buxhetin vjetor, në shumën 38,195,167 lekë, për të kryer pagesat e prapambetura të TVSH-së, për projektin “Modernizimi i sistemit shëndetësor”.

Në masat për shpërblim dëmi është kërkuar për shpërblimin e dëmit prej **1,155,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR]; vlera prej **5,533 USD** padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR]; vlera **21,944 USD** padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR]; vlera **2,475 Euro** padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR].

Bazuar në në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të KM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, **është kërkuar fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore:**

- “**Largim nga shërbimi civil**” për punonjësin [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Financiar, në cilësinë e përgjegjës për implementimin e projektit për “Modernizimi i sistemit shëndetësor Shqiptar”, në aspektet teknike, financiare dhe prokuruese të tij, për arsye se:
 - Ka kryer tejkalime të financimeve sipas komponentëve dhe nënkomponentëve të Projektit “Modernizimi i sistemit shëndetësor Shqiptar”, dhe për këto tejkalime, nuk ka amendime për rialokimin e fondeve.
 - Ka tejkaluar numrin e punonjësve të stafit të Njesisë së Zbatimit të Projektit. Njësia e Zbatimit të Projektit është e përbërë nga një staf prej 5 persona, nga 3 persona që janë të përcaktuar në marrëveshjen e financimit, pra janë lidhur kontrata dhe janë paguar për periudhën 2006-2012 më tepër dy persona në vlerën 9,030,000 lekë”.
 - Ka kryer lidhjen e kontratave me të 4 anëtarët e stafit të Njesisë së Zbatimit të Projektit, ***pa delegim kompetence nga Ministri ose përfaqësuesi i tagrave tij.***
 - Ka përdorur fondet e kredisë jashtë destinacionit në vlerën 2,081 USD, pa zbatuar procedurat për rialokimin e tyre, për financimin e konsulentit ndërkombëtar [REDAKTUAR], në kundërshtim me kushtet e pagesës të përcaktuar në kontratë, ku përcaktohet që financimi do të bëhet nga Granti Japonez.
 - Nuk ka llogaritur, bërë ndalesat dhe derdhur detyrimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të stafit të Njesisë së Zbatimit të Projektit, për periudhën që nga shtatori i vitit 2006 deri në qershor të vitit 2012, në vlerën 5,080,633 lekë.
 - Në katër raste për vlerën 1,155,000 lekë, 9,081 USD dhe 2,475 Euro, ka bërë shtesa të kontratave me shoqëritë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe me konsulentin [REDAKTUAR], pa delegim kompetence nga Ministri, ose përfaqësuesi i tagrave të tij.
 - Nuk ka arkivuar dokumentacionin e Projektit (Dokumentacionin e procedurave të tenderimit, dokumentacionin financiar etj). Ky dokumentacion mbahet në zyrën e Drejtorisë së Planifikimit Financiar dhe në zyrën e tij, dhe jo në arkivën e Ministrisë.
 - Ka kryer fillimin e procedurave të tenderimit ***me një deri në dy muaj, para daljes së Urdhër Prokurimit nga Ministri, pa delegim kompetence nga Ministri ose zëvendësuesi i tagrave të tij, duke arritur deri në publikimin ftesave për ofertë në faqen e UNDP Online dhe DG Market.***
 - Nuk i krijoi grupit të auditimit akses në e-mail zyrtar të Drejtuesit të Projektit me Bankën Botërore (BB), për të audituar korrespondencat e Drejtuesit të Projektit me Bankën Botërore, si dhe akses në faqen zyrtare të BB, ku janë publikuar procedurat e tenderimit.

- Nuk vuri në dispozicion të grupit të auditimit, të gjithë dokumentacionin origjinal të procedurave të prokurimit, por vuri në dispozicion dokumentacion të fotokopjuar ose të skanuar.
- Ka vonuar për tre javë (nga data 10.09.2013 deri më 09.09.2013), vënien në dispozicion të grupit të auditimit, dokumentacionin e zbatimit të kontratave të pajisjeve mjekësore dhe të IT.
- Nga auditimi nuk është provuar zotërimi i gjuhës angleze nga të gjithë anëtarët e KVO, çka kompromenton zhvillimin e procedurave të tenderimit (të cilët janë zhvilluar në gjuhën angleze), duke çuar në konkluzionin se vlerësimi i operatorëve ekonomik në shumicën e rasteve është kryer në mënyrë të njëanshëm nga z. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Financiar, në cilësinë e përgjegjës për implementimin e projektit në aspektet teknike, financiare dhe prokuruese të tij, pasi në shumicën e rasteve ka qenë anëtar dhe në një rast kryetar i KVO..
- Ka urdhëruar zbatimin e kontratave të lidhura për pajisjet mjekësore, pa delegim kompetence nga Ministri i Shëndetësisë ose përfaqësuesi i tagrave të tij.
- Ka kryer blerjen e karburantit për Projektin në vitin 2009, 2010, 2011 dhe 2012, me procedurë për blerjet me vlera të vogla, pa delegim kompetence nga Ministri i Shëndetësisë ose zëvendësuesi i tagrave të tij, pasi ka nxjerrë urdhërin e prokurimit me vlera të vogla, urdhërin për ngritjen e komisionit të blerjeve të vogla (anëtarët janë nga stafi i NJZP), lidhjen e kontratës me shoqërinë [REDAKTUAR], urdhrin e brendshëm për pagesën, firmosjen dokumentit bankar dhe të urdhër pagesës.

- *“Vërejtje me shkrim”*, për gjashtë punonjës:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e Kryetarit i KVO (nga data 07.05.2007 deri më 06.02.2008), në tenderin e zhvilluar për “Pajisjeve të IT për Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”, për projektin, viti 2007-2008, tenderi parë i anuluar.
2. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, në cilësinë e anëtarit të KVO (nga data 07.05.2007 deri më 06.02.2008) në tenderin e zhvilluar për “Pajisjeve të IT për Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”, për projektin, viti 2007-2008, tenderi parë i anuluar.
3. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në ISKSH, në cilësinë e anëtarit të KVO (nga data 07.05.2007 deri më 28.08.2007), në tenderin e zhvilluar për “Pajisjeve të IT për Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”, për projektin”, viti 2007-2008, tenderi parë i anuluar.
4. [REDAKTUAR] me detyrë Specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit në ISKSH, në cilësinë e anëtarit i KVO, në tenderin e zhvilluar për “Pajisjeve të IT për Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”, për projektin, viti 2007-2008, tenderi parë i anuluar.
5. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në ISKSH në cilësinë e anëtarit të KVO (nga data 06.02.2008 deri më datë 20.05.2008) në tenderin e zhvilluar për “Pajisjeve të IT për Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”, për projektin, viti 2007-2008, tenderi parë i anuluar.
6. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të IT-së, në MSH, në cilësinë e anëtarit të KVO (nga data 28.08.2007 deri më datë 20.05.2008) në tenderin e zhvilluar për “Pajisjeve të IT për Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”, për projektin, viti 2007-2008, tenderi parë i anuluar, pasi:
 - kanë skualifikuar në mënyrë të padrejtë të operatorit ekonomik [REDAKTUAR], dhe kanë anuluar padrejtësisht procedurën e prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin e BB viti 2004 për prokurimet.

• “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, për tetë punonjës:

1. [REDACTED] me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Inxhinierisë Klinike (Biomedikali), në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me profesion inxhinier.
2. [REDACTED] me detyrë Inxhinier në Njësinë e Inxhinierisë Klinike (Biomedikali), në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me profesion Inxhinier Elektronike e trajnuar për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore.
3. [REDACTED] me detyrë Teknik në Njësinë e Inxhinierisë Klinike (Biomedikali), në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me profesion teknik i mesëm me specialitet mekanik, për:

-Pranimin dhe kolaudimin e pajisjeve mjekësore për Shërbimin e Kardiologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, pa dokumentacionin e plotë ligjor të përcaktuar kontratën e lidhur me [REDACTED] dhe me [REDACTED] në datën 28.02.2012. Dokumentacioni që shoqëron pajisjen nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht në shumicën e rasteve një pjesë të dokumentacionit mungon, ndërsa një pjesë tjetër është jo në origjinal, i skanuar ose/dhe i fotokopjuar.

4. [REDACTED] me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Inxhinierisë Klinike (Biomedikali), në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me profesion Inxhinier Elektrike
5. [REDACTED] me detyrë Inventarizuese në Sektorin Financë-Kontabilitet në Drejtorinë Ekonomike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me profesion ekonomiste.

6. [REDACTED] me detyrë Inventarizuese në Sektorin Financë-Kontabilitet në Drejtorinë Ekonomike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me profesion ekonomiste.

7. [REDACTED] me detyrë Teknik në Njësinë e Inxhinierisë Klinike (Biomedikali), në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me arsim të mesëm.

8. [REDACTED] me detyrë Inxhinier në Njësinë e Inxhinierisë Klinike (Biomedikali), në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), me profesion inxhinier elektroteknik për industrinë. Për:

-Pranimin dhe kolaudimin e pajisjeve mjekësore pa dokumentacionin e plotë ligjor të përcaktuar kontratën e lidhur me [REDACTED], [REDACTED] dhe me [REDACTED] me datën 28.02.2012, për lotin 3, 4 dhe 5. Dokumentacioni që shoqëron pajisjen nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht në shumicën e rasteve një pjesë të dokumentacionit mungon, ndërsa një pjesë tjetër është jo në origjinal, i skanuar ose/dhe i fotokopjuar.

- Për lotin 5 me vlerë prej 192,000 euro, dokumentacioni që shoqëron pajisjen nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht në shumicën e rasteve një pjesë të dokumentacionit mungon, ndërsa një pjesë tjetër është jo në origjinal, i skanuar ose/dhe i fotokopjuar. Në dosje ndodhet akt-kolaudimi i datës 13.07.2012 për pritjen dhe kolaudimin e pajisjes, i nënshkruar nga Komisioni i kolaudimit të QSUT-së, i përbërë nga përfaqësuesit e QSUT-së [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], për pajisjen mjekësore të sipërpërmendur. Pajisjet janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrje nr. 25 datë 27.06.2012. Siç rezulton nga datat e fletë hyrjes dhe akt kolaudimit, **ky akt kolaudim është formal, pasi është kryer 14 ditë pas bërjes hyrje të mallit në magazinë.**

-Pranimin dhe kolaudimin e pajisjes mjekësore EKO kardiake, pa dokumentacionin e plotë ligjor të përcaktuar kontratën e lidhur me [REDACTED] në datën 28.02.2012, për lotin 6 me vlerë 206,868 Euro, për pajisje mjekësore në Shërbimin e Kardiologjisë në QSUT. Dokumentacioni që shoqëron pajisjen nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht në shumicën e

rasteve një pjesë të dokumentacionit mungon, ndërsa një pjesë tjetër është jo në origjinal, i skanuar ose/dhe i fotokopjuar.

-Pranimin dhe kolaudimin e pajisjes mjekësore për kontratën e lidhur me [REDAKTUAR], më datën 28.02.2012, me vlerë prej 477,000 Euro (pa tvsh), Dokumentacioni që shoqëron pajisjet nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht në shumicën e rasteve një pjesë të dokumentacionit mungon, ndërsa një pjesë tjetër është jo në origjinal, i skanuar ose/dhe i fotokopjuar.

Mbështetur në Kodin e Procedurës Penale, neni 281, është kërkuar kallzim penal për z. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Financiar, në cilësinë e përgjegjës për implementimin e projektit në aspektet teknike, financiare dhe prokuruese të tij, me akuzën e shpërdorimit të detyrës, për:

- tejkalime të financimeve sipas komponentëve të Projektit, pa amendime të marrëveshjes për rialokimin e fondeve;
- në mungesë të delegimit të kompetencave për ushtrimin e disa detyrave nga Ministri ose përfaqësuesi i tagrave të tij, konkretisht:
 - ka nënshkruar kontratat e punësimit me 4 punonjësit e stafit të Njesisë së Zbatimit të Projektit,
 - ka bërë shtesa të kontratave për katër raste, për vlerën 1,155,000 lekë, 9,081 USD dhe 2,475 Euro duke shkelur barazinë në tendera, si dhe duke i shkaktuar dëm ekonomik Ministrisë së Shëndetësisë në shumat e mësipërme,
 - ka kryer fillimin e procedurave të tenderimit me një deri në dy muaj para daljes së Urdhrit të Prokurimit nga Ministri,
 - ka urdhëruar zbatimin e kontratave të lidhura për pajisjet mjekësore, pa pasur të parashikuar ligjërisht nj kompetencë të tillë,
 - në periudhën 2009 – 2012, ka kryer blerjen e karburantit për Projektin me procedurë për blerjet me vlera të vogla;
 - ka përdorur fondet e kredisë jashtë destinacionit në vlerën 2,081 USD, pa zbatuar procedurat për rialokimin e tyre;
- nuk ka llogaritur, bërë ndalesat dhe derdhur detyrimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të stafit të Njesisë së Zbatimit të Projektit në vlerën 5,080,633 lekë;
- nuk i krijoi grupit të auditimit akses në e-mail zyrtar të Drejtuesit të Projektit me Bankën Botërore (BB), si dhe nuk vuri në dispozicion të gjithë dokumentacionin origjinal të procedurave të prokurimit, duke penguar veprimtarinë audituese;
- ka krijuar përqendrim të kompetencave te Drejtuesi i Projektit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të përcaktuar për detyrën e tij.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shënim: Auditimi u krye nga z. Fatmir Iliazi përgjegjës i grupit, zj. Luljeta Shtylla dhe z. Alfons Gabili. Më tej u shqyrtua nga z. Gjovalin Preçi Kryeauditues, Drejtori i Departamentit z. Xhafer Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm zj. Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT